



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:008808

Datë: 22.02.2022

Numri i dokumentit: 02738927

PKR.nr. 9/2022

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, me gjyqtaren Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarës M. M nga fshati V , K- P., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/L.nr. 14/22 të dt.18.01.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, e akuzuara M. M me dt. 22.02.2022, mori dhe të njëjtën ditë e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**E akuzuara:**

**M.M.**, e lindur me dt. ...., në P tani me banim ne fshatin V nga i ati M dhe e ëma V, e gjinisë K , me profesion ....., e ....., gjendjes se dobët ekonomike, posedon telefon me nr. ...., me nr. personal ....., Shqiptare, Shtetas e Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTORË**

**Për shkak se:**

-Me parë e gjerë me datën 10.01.2021 rreth orës 02:30 min, në rr. "M.T" në P., në kundërshtim me nenin 3 par.1 pika 1.4 të Ligjit për armë Nr.05/L-022, ka mbajtur në pronësi dhe kontroll armën – SPREJIN – .. me mbishkrimin "N..", në atë mënyrë që policia gjatë bastisjes dhe kontrollit të veturës ..... ngjyrë të zezë me targa te regjistrimit ....., në sirtarin e derës së veturës, të pandehurës i gjejnë dhe sekuestrojnë armën-sprejin, me të dhënat e cekura si më lart.

- me çka ka kryer veprë penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,38,39,40,43,69, të KPRK-së, nenit 366 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPRK-së, të akuzuares i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarës M.M i cakton dënim me gjobë në lartësi prej 100€ (njëqind euro), të cilin dënim është e obliguar që ta paguaj më së largu në afat prej 3 (tre) muaj nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse e akuzuara e lartcekur dënimin e lartcekur nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Te akuzuarës M.M, i konfiskohet arma – SPREJI – .. me mbishkrimin “N..”.

E akuzuara obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 15€ (pesëmbëdhjetë euro), si dhe shumën 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të viktimave, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr. 14/22 të dt. 18.01.2022, kundër të akuzuarës M.M nga fshati V, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorja e shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 22.02.2022, gjykata është bindur se e akuzuara e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarës i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarën për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe e akuzuara M.M ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë pasi që është i vullnetshëm dhe është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarës vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarës pasi që e njëjta i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë dhe se pranimi e fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata e ka shpall fajtores të akuzuarën bazuar në pranimin e fajësisë dhe provat që janë në shkresat e lëndës siç janë raporti i policit G.K me nr....-...-... te dt. 10.01.2022, raporti i policit hetues E.S me nr ...-...-... te dt. 10.01.2022, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sprejtit të dt. 10.01.2022, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjykata nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana për përjashtimin e përgjegjesisë penale të akuzuarës, andaj e akuzuara është penalisht përgjegjëse.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se: e akuzuara e ka pranuar fajësinë, premtan se nuk do të përsëriten veprime të tilla, e gjendjes së dobët ekonomike, studente. Ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarën gjykata nuk gjeti asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke pas parasysh gjendjen e dobët ekonomike të të njëjtës, duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjesisë penale të akuzuarës dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarës në kryerjen e veprës penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së u konfiskua Spreji i cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konform nenit 450 të akuzuarën e obligon në paguarjën e shpenzimeve procedurale.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarën e lartcekur që ti paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

**2022:008808, 22.02.2022**

**Kryetarja e trupit Gjykses**

**Violeta Husaj – Rugova**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.